



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

**AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY**

FTESA PËR SUBVENCIONIM PËR ORGANIZATAT JO QEVERTARE –HULUMTUESE, 2022

ABGJ shpallë thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve hulumtuese dhe analitik të OJQ-ve që kontribuojnë në zbatimin e prioriteteve të parapara në Objektivat Strategjike të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 dhe planit të tij të veprimit, respektivisht : analizave gjinore dhe hulumtimeve që analizojnë gjendjen e grave dhe burrave sipas objektivave Strategjike.

SHTYLLA III: Të Drejtat e Grave, Qasja në Drejtësi dhe Siguria

1. Analizën e situatës nga aspekti gjinor i pozitës së grave të dënuara për dhunën në familje duke përfshi politikën ndëshkimore për rastet e grave -dhunuese
2. Realizimi i hulumtimit për përfaqësimin e grave dhe vajzave në pozitat vendimmarrëse në sektorin publik dhe privat

Qëllimi

Agjencia për Barazi Gjinore përmes kësaj thirrjeje në zbatim të drejtpërdrejtë të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit 2020-2024, respektivisht *Objektivit strategjik 3: Avansimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi garantues i arritjes së barazisë gjinore.*

Hulumtimet dhe analiza e situatës për fushat e lartpërmendura duhet të arrijnë që në dy fusha:

- I. Të analizoj dhe krahasoj politikën ndëshkimore përmes analizave kualitative të grave të dënuara për krime të dhunës në familje duke analizuar kornizën ligjore dhe vendosjen e qasjes krahasimtare ndaj dy gjinive, për krimet njëjta dhe dënimet brenda sistemit juridik të RKS.
- II. Të hulumtoj situatën e grave dhe vajzave në administratën publike dhe sektorin privat përmes identifikimit të faktorëve kyç, mundësive dhe pengesave që rezultojnë me situatën aktuale të përfaqësimit të grave dhe vajzave në nivel menaxherial dhe vendimmarrës, të ofroj rekomandime

Agjencia për Barazi Gjinore u bënë thirrje për aplikim të gjitha organizatave jo qeveritare, organizatave te grave, të regjistruara në Republikën e Kosovës mandati i të cilave është i fokusuar dhe profilizuar në fushën e hulumtimeve kuantitative dhe kualitative në barazi gjinore dhe të drejta të njeriut, me ekspertizë të dëshmuar profesionale.

Ftesa për propozime shpallet në ueb faqen e Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit <https://abgi.rks-gov.net/>.

Fushëveprimi

Në kuadër të thirrjes për mbështetje të këtyre iniciativave, ABGJ me anë të mbështetje së organizatave të shoqërisë civile, organizatave të grave, synon të arrij vlerësim të pa anshëm, të pa varur dhe korrekt, bazuar në të dhëna cilësore të verifikuara, dhe sjelljen e rekomandimeve, të cilat do ta shërbejnë ABGJ-në planifikimin dhe identifikimin e aktiviteteve të cilat duhet të propozohen në planin e ri të veprimit të PKBGJ – së 2024-2028, i cili do të hartohet nga ABGJ. Këto të gjetura dhe rekomandime do te udhëzojnë për ndërmarrjen e veprimeve që përmirësojnë qasjen e grave në sport, qasje në drejtësi, dhe pjesëmarrje adekuate në vendimmarrje në administratë publike. Sipas kësaj thirrje parashihen fusha prioritare, sipas specifikave në vijim:

- 1. Mbështetjen e analizës për dënimet e shqiptuara për kryeset e veprave të dhunës në familje, të dënuara për krimet e kryera.** Analiza e situatës të zhvillohet për raste individuale çdo here duke ruajtur, mbrojtur identitetin, të dhënat personale dhe te dhëna të tjera të klasifikuara. Të vendoset një njësi krahasuese e dënimeve mes gjinive sipas rekordeve të institucioneve të RKS. OJQ-te apo organizatat e grave qe aplikojnë për këtë thirrje duhet ta dëshmojnë ekspertizën dhe eksperiencën e bashkëpunimit me organet e drejtësisë në angazhime paraprake, përmes analizave hulumtuese me fokus dhunën në familje apo dhunën ndaj grave, apo iniciativave të përbashkëta me organet e drejtësisë. Rekomandimet e kësaj analize do të ndihmojnë institucionet në vendosjen dhe përdorimin e mekanizmave më adekuat të trajtimit dhe parandalimit të dhunës në familje, dhunës në bazë gjinore. Në kuadër të metodologjisë së propozuara, aplikuesit duhet të specifikojnë qasjen që do të përdorin për aktivitete, si dhe mënyrën se si do të sigurojnë mbrojtjen e konfidencialitetit të personave të intervistuar dhe rasteve të prezantuara.
- 2. Mbështetje për hulumtimin i cili adreson sfidat për pjesëmarrje në vendimmarrje** me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat ne administratë publike dhe sektor privat, duke identifikuar ato, dhe ofruar rekomandime konkrete për përmirësim sipas kërkesave të garantuara me kornizë ligjore.

1. E drejta e aplikimit

Të drejtën e aplikimit e kanë të gjitha OJQ-të që:

- Janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës prej së paku 2 vite para datës së publikimit të thirrjes publike,
- Kanë së paku dy (2) vite eksperiencë pune të dëshmuar (përmes kontratave-, projekteve te realizuara) në fushat e lartpërmendura hulumtime - barazi gjinore dhe të drejta të njeriut, hulumtime dhe analiza gjinore në legjislacion/dhuna ndaj grave, ekonomi dhe barazi gjinore , të drejtat e njeriut dhe anti diskriminimi etj

- Dëshmojnë se kanë ekspertizë profesionale të dëshmuar në fushat e lartpërmendura të dëshmuara me CV e ekspertëve të angazhuar, (të dëshmuara me kontrata të punës apo marrëveshje të shërbimeve) - barazi gjinore, të drejtat e njeriut.

2. Përkrahja financiare

Thirrja për aplikim financohet nga fondet publike të ABGJ-së, specifikisht buxheti i Kosovës për vitin 2022, nga vija buxhetore “Grante dhe Subvencione”, në shumën totale 30,000 Euro.

- Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 30,000.00 Euro.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që do të ndahet për çdo projekt individual është 8,000.00 Euro, ndërsa shuma maksimale është 15,000.00 Euro.
- OJQ-të mund të aplikojnë në kuadër të kësaj thirrje **vetëm me një (1) projekt** për një nga fushat prioritare sipas thirrjes.

3. Kohëzgjatja e projektit

- Periudha e zbatimit të projektit është dy (2) muaj nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes.

4. Kriteret

a. Kriteret e përgjithshme

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- 1.1 të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asocimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- 1.2 të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-në e huaj;
- 1.3 vërtetim tatimor jo më të vjetër së 3 muaj, ku specifikon se aplikanti nuk ka borxhe të pashlyera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.
- 1.4 të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit; (formulari 13)
- 1.5 të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; (formulari 11)
- 1.6 të mos jetë në proces të falimentimit apo çregjistrimit të organizatës, të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/ udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. (Formulari 15)
- 1.7 Në rast se projekti/hulumtimi do të implementohet në partneritet, dëshmi/marrëveshje mes partnerëve për përgjegjësitë e secilit partner në projekt. (Formulari 12)

2. Me qëllim të dëshmimit për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, për paragrafët 1.1 ,1.2. të këtij neni, aplikuesi dorëzon certifikatat përkatëse; për paragrafin 1.3 vërtetimin tatimor në emër të aplikuesit i lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, dhe 1.4, 1.5., 1.6 dhe 1.7. aplikuesi nënshkruan dhe dorëzon deklaratat përkatëse.

3. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme, aplikuesi nuk mund të kualifikohet për mbështetje financiare.

b. Kriteret Specifike

Në mënyrë që aplikacioni të konsiderohet i kompletuar, aplikuesi duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- 1.1. të dorëzojnë brenda afatit të thirrjes projekt propozimin i cili ndër të tjera përmban: a) qëllimin e hulumtimit/analizës, b) metodologjinë e realizimit të hulumtimit/analizës, c) objektivat specifike të hulumtimit/analizës, d) aktivitetet e detajuara, e) kalendarin e realizimit, f) lokacionin e zbatimit të projektit, g) rezultatet e synuara, h) rreziqet dhe qëndrueshmërinë, i) monitorimin dhe vlerësimin e projektit, j) target grupet e identifikuara për intervistim duke përfshirë numrin e tyre, moshën, gjininë, pozitën gjeografike, statusin social etj.
- 1.2. projekt propozimi i hulumtimit apo analizës të jetë i shoqëruar me një propozim buxhet për secilin aktivitet të ndërmarrë për realizimin e hulumtimit/analizës, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe Manualit për zbatimin e Rregullores 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, duke përshkruar dhe specifikuar në mënyrë të kurtë secilin shpenzim brenda linjave buxhetore të propozuar.
- 1.3. të dorëzojë të dhëna për stafin/personelin e projektit, ekspertët/kontraktorët dhe hulumtuesit/anketuesit duke specifikuar qartë detyrat e secilit, siguron CV-të e tyre, referenca nga angazhimet e tilla paraprake, së bashku me një deklaratë/para kontratë me secilin që planifikohet të angazhohen për zbatimin e projektit, realizimin e hulumtimit/analizës, në rast të përfitimit të mbështetjes financiare.
- 1.4. nëse është e aplikueshme; të sigurojnë dëshmitë e duhura për hulumtim/analizë për të cilat kërkohet bashkëfinancim.
- 1.5. të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e hulumtimeve/analizë në fushën e barazisë gjinore, të drejtat e njeriut, dhuna ndaj grave, duke siguruar dëshmi të realizimit të hulumtimeve të ngjashme në të kaluarën, së paku dy abstrakte të hulumtimeve/analizave gjinore të realizuara,
2. Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret specifike, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.
3. Agjencia ruan të drejtën për të kërkuar informacione apo dokumente plotësuese sipas diskrecionit të saj për të sqaruar çfarëdo dileme të Komisionit Vlerësues.
4. Aplikanti duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret specifike duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas dispozitave të këtij neni dhe thirrjes publike.
5. Secili nga aplikantët do i nënshtrohet kontrollit administrativë, duke u bazuar në kriteret e përgjithshme dhe specifike.
6. Të drejtat pronësore të hulumtimeve, analizave, dhe gjitha dokumenteve që do të prodhohen i mbetën ABGJ-së
7. Hulumtimet dhe analizat do të ofrohen për komentim në çdo fazë të monitorimit,
8. Versioni final do të dorëzohet në gjuhën shqipe i lekturuar dhe korrigjuar

c. Kriteret e vlerësimit nga aspekti përmbajtjesor

Projekt-propozimet do të vlerësohen sipas kriterëve në vijim:

Kriteri	Përshkrimi	Vlerësimi me pikë
Përvoja profesionale	<ul style="list-style-type: none">A posedon aplikuesi përvojë të mjaftueshme dhe kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të hulumtimit/analizës?	35 pikë
Objektivat e qarta	<ul style="list-style-type: none">A janë objektivat e hulumtimit/analizës gjinore të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?	20 pikë
Aktivitetet e realizueshme	<ul style="list-style-type: none">A janë aktivitetet e projektit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme? A janë aktivitetet të ndërlidhura me realizimin e objektivave? A janë aktivitetet të ndërlidhura mes tyre?	15 pikë
Rezultatet e arritshme	<ul style="list-style-type: none">A janë përcaktuar qartë rezultatet dhe a tregohet se si aktivitetet çojnë në arritjen e rezultateve?	15 pikë
Kosto e arsyeshme	<ul style="list-style-type: none">A janë kostot e hulumtimit/analizës gjinore reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?A janë kostot e projektit në përputhje me aktivitetet e planifikuara të hulumtimit/analizës gjinore	15 pikë

5. Procesi i aplikimit

Të gjitha organizatat që plotësojnë kriteret për aplikim mund të aplikojnë duke plotësuar formularët në vijim:

1. *Formulari 9* - Formulari i aplikacionit për projekt/program (e detyrueshme)
2. *Formulari 10* - Formulari i buxhetit (e detyrueshme)
3. *Formulari 11* - Formulari i deklaratës për të financimit të dyfishtë (e detyrueshme)
4. *Formulari 12* - Formular i deklaratës se partneritetit (nëse aplikohet)
5. *Formulari 13* - Formulari i deklaratës se projekteve të financuara (e detyrueshme)
6. *Formulari 14* - Deklaratë mbi aktivitetete përshkruara të programit /projektit (e detyrueshme)
7. *Formulari 15*- Deklarate e përshtatshmërisë/pranueshmerisë dhe shmangies së konflikt të interesit.

6. Dokumentacioni i kualifikues

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së
2. Certifikatën e numrit fiskal
3. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve)
4. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (obligative)
5. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi
6. Deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet tjera
7. Deklaratë se OJQ ka përgatitur dhe dorëzuar pasqyrat financiare vjetore
8. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme
9. Të dorëzoj deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;
10. Të dorëzoj parakontratat së bashku me CV-të e menaxherit të projektit dhe stafit implementues/eksperteve dhe kontraktorëve.
11. Të dërgojë dëshmi/referenca të implementimit të projekteve/programeve të ngjashme.

7. Dorëzimi i aplikacioneve

OJQ-të duhet t'i dorëzojnë formularët e plotësuar për aplikim:

- a. Ne kopje fizike- ne zarf të mbyllur në Agjencinë për Barazi Gjinore / Zyra e Kryeministrit (Ndërtesa e Qeverisë, Sheshi "Nëna Terezë" 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, Kati VII, Zyra Nr.711) nga ora 13:30-15:30
- b. Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: fahri.restelica@rks-gov.net ose Fatime.Bajraktari@rks-gov.net

Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit: www.abgj-rks-gov.net.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Afati i fundit për aplikim

- Afati për aplikim është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas datës së publikimit të ftesës për propozime (**17/08/2022- 31/08/2022**) ora 15:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas mbylljes së afatit nuk do të merren parasysh.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës publike janë të detajuara në Udhëzuesin për Aplikim.